

AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “SINDER AB”sh.p.k.

Adresa: Rr. “Shefqet Ndroqi”, Sanatorium, Tirane, Cel: 0682049311, e-mail:
Sindera_b@yahoo.com

* * *

Procedura e prokurimit: E Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti 1: Blerje veshje nëntokësore varri, REF-15847-03-29-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Loti 1: Blerje veshje nëntokësore varri, sasia e kerkuar eshte 3200 complete veshje nentokesore varri per te rritur (te thjeshta), 20 complete veshje nentokesore varri per te rritur (speciale) dhe 60 complete veshje nentokesore varri per te mitur. Afati i levrimit te mallit eshte nga data e nenshkrimit te kontrates e deri me date 31.12.2019.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.14, date 08.04.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “SINDER AB”sh.p.k.

K01531003W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **9 890 000 (nente milion e teteqind e nentedhjete mije) leke pa TVSH.**

(me numra dhe fjalë)

2. Operatori ekonomik “SIRETA 2F”sh.p.k.

K51501008J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **8 200 000 (tete milion e dyqind mije) leke pa TVSH.**

(me numra dhe fjalë)

3. Operatori ekonomik “MENI”sh.p.k.

J61909018W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **9 082 800 (nente milion e tetedhjete e dy mije e teteqind) leke pa TVSH.**

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “SIRETA 2F”sh.p.k.

Emri i plotë i shoqërisë

2. Operatori ekonomik “MENI”sh.p.k.

Emri i plotë i shoqërisë

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

K51501008J

numri i NIPT-it

J61909018W

numri i NIPT-it

* * *

1. Operatori ekonomik “SIRETA 2F”sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik “SIRETA 2F” sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit.
- Ka plotesuar te gjitha kriteret e veçanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar.
- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit teknik.

Kriteri 1: Ne DST ne shtojcen 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” te kapaciteti teknik ne piken 1, modifikuar me shtojcen 1 date 12.04.2019 eshte kerkuar per Loti 1:

*“Furnizime te ngjashme ne masen 40% te vleres se **fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurron**, te realizuar nga operatoret ekonomik gjate tre viteve te fundit nga data e tenderimit. Per kete duhet te paraqiten;*

- Kontrata furnizimi te ngjashme, vertetim te leshuar nga nje ent publik dhe fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

-Kur furnizimi i ngjashem është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do ta vertetojë furnizimin duke paraqitur faturën tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.”

Operatori ekonomik “SIRETA 2F” sh.p.k ka paraqitur tre kontrata, nga te cilat nje eshte kontrate furnizimi dhe dy jane kontrata pune.

- Kontrate furnizimi me nr.prot.9/8, date 22/05/2017, me objekt “Blerje inerte” te nenshkruar me Drejtorine e Pergjithshme nr.2 te Punetoreve te Qytetit, bashkelidhur shtojca 10 ne vleren totale 28 444 175 leke pa TVSH; Akt marreveshje nr.prot.9/11 date 13.12.2017; Vertetim per realizim kontrate nr.prot.1429/1 date 18.05.2018; fatura tatimore nr.34 date 18.09.2017; fatura tatimore nr.42 date 07.11.2017; fatura tatimore nr.53 date 15.12.2017.

- Kontrate per realizim “Pune” me nr.prot 4308, date 11.12.2017 me objekt “ Sistemim Rrugesh Blloku te Stadiumi” te nenshkruar me Bashkine Pogradec; Shtojca 8 Formular vleresimi; Amendim nr.1 nr.prot. 1879/2 date 05.04.2017 “Per nje ndryshim ne kontraten nr.prot 4308, date 11.12.2017 me objekt “ Sistemim Rrugesh Blloku te Stadiumi”; Amendim nr.2 nr.prot. 1879/1 date 05.04.2018 “Per shtyrjen e punimeve me objekt “ Sistemim Rrugesh Blloku te Stadiumi”; Situacion perfundimtar nr. 5 periudha e punimeve date 03.01.2018-03.10.2018; Procesverbal kolaudimi me objekt “ Sistemim Rrugesh Blloku te Stadiumi Bashkine Pogradec”; Çertifikata e perkoheshme e marrjes ne dorezim te punimeve date 15.11.2018; fatura tatimore nr. 12 date 16.03.2018 ; fatura tatimore nr. 15 date 23.05.2018; fatura tatimore nr. 20 date 04.06.2018; fatura tatimore nr. 30 date 07.09.2018; fatura tatimore nr. 41 date 08.10.2018.

-- Kontrate Pune me nr.prot (i paqarte), date 16.12.2016 me objekt “Ndertim rruga Demokracia Ura Q.Babru-Ura F.Kerçike” te nenshkruar me Kamez; Formulari i kontrates date 16.12.2016; Formular vleresimi; Procesverbal mbi perfundimin e punimeve te ndertimitne objektin “Ndertim rruga Demokracia Ura Q.Babru-Ura F.Kerçike”; Procesverbal kolaudimi date 17.08.2017; Situacion perfundimtar nr.5 objekt “Ndertim rruga Demokracia Ura Q.Babru-Ura F.Kerçike”; fatura

tatimore nr. 5 date 02.03.2017 ; fatura tatimore nr. 10 date 10.05.2017; fatura tatimore nr. 14 date 07.06.2017; fatura tatimore nr. 38 date 20.10.2017; fatura tatimore nr. 6 date 05.02.2018. Formular vleresimi; Kontrate pune shtese nr.prot.588 date 22.09.2017 me objekt “Ndertim rruga Demokracia Ura Q.Babru-Ura F.Kerçike; Procesverbal kolaudimi 2018, situacion perfundimtar nr.2; fature tatimore nr.19 date 04.06.2018; fature tatimore nr.43 date 19.11.2018.

Ne nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, pika 4 te VKM nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Ne nenin 26 “Kontrata per pune publike”, pika 6 te VKM nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.”

Ne nenet 26 dhe 27 te VKM nr.914, date 29.12.2014 eshte bere ndarja midis kontratave te furnizimit te mallrave dhe kontratave te puneve publike dhe dokumentet qe duhet te kerkohen ne secilin rast.

Per permbushjen e ketij kriteri (furnizimeve te ngjashme) duhet te plotesohen tre komponente qe jane: koha e realizimit te furnizimeve, natyra e ngjashme e furnizimeve me objektin qe prokurohet dhe vlera deri ne 40% te vleres se fondit limit per secilin lot qe prokurohet / shumatores se loteve per te cilat konkurron.

Nga kontratat e paraqitura nga ofertuesi “SIRETA 2F”sh.p.k, plotesohet komponenti i pare i kohes se realizimit te furnizimeve, pasi kontratat jane te realizuar brenda afatit tre vjecar nga data e tenderimit.

Ofertuesi “SIRETA 2F”sh.p.k, nuk ploteson dy komponentet e tjere te natyres se ngjashme te furnizimeve qe permbajne kontratat me objektin e prokuruar nga autoriteti kontraktor dhe te vleres se realizuar te furnizimeve te kerkuara te analizuar si me poshte:

- Me Kontraten e furnizimit me nr.prot.9/8, date 22/05/2017, me objekt “Blerje inerte” te nenshkruar me Drejtorine e Pergjithshme nr.2 te Punetoreve te Qytetit, operatori ekonomik ka furnizuar ne masen 100% me inerte te cilat nuk jane furnizime te ngjashme me objektin tone te prokurimit.

Autoriteti yne kontraktor ne prokurimin e publikuar ka objekt te saj furnizime me elemente beton/arme e pasqyruar ne specifikimet teknike bashkelidhur dok. te tenderit, ku qartesisht jane publikuar skicat teknike te elementeve beton/arme te mallrave te kerkuara dhe jo furnizime me materiale inerte, hidraulike apo elektrike.

Inertet **jane material ndertimi i fraksionuar ne permasa** sipas kerkesave te investitorit si psh. Cakull, rrere zhavor etj, ndersa veshjet nentoksore te varrit dhe bordurat provizore te varrezave **jane elemente beton/arme te parapergatitur me nje teknologji te caktuar**. Si elemente kane forme, permasa dhe specifikime teknike te caktuara, te cilat jane paraqitur ne dokumentacionin teknik te prokurimit publik. Cdo llogaritje per percaktimin e fondit limit eshte bere ne baze te ketij klasifikimi.

Menyra e transportit midis inerteve dhe elementeve te parapergatitur beton-arme eshte krejtesisht e ndryshme. Kemi te bejme me element beton-arme te cilat per shkak te trashesise se tyre 4 cm dhe me gjatesi 1.80m (bordurat permasa max) dhe 1.05 (veshjet nentoksore), cka do te thote zbatim rigoroz i KT ne transport per te evituar plasaritje apo dhe thyerje te ketyre elementeve, gje e cila nuk mund te thuhet per materialet inerte.

Per sa u parashtrua me siper, operatori ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k nuk e ploteson kriterin e furnizimeve te ngjashme me kontraten e mesiperme.

-Me kontratat e puneve, perkatesisht: kontrata me nr.prot 4308, date 11.12.2017 me objekt " Sistemim Rrugesh Blloku te Stadiumi" te nenshkruar me Bashkine Pogradec dhe Kontrata me nr.prot (i paqarte), date 16.12.2016 me objekt "Ndertim rruga demokracia Ura Q.Babru-Ura F.Kerçike" te nenshkruar me Bashkine Kamez, operatori ekonomik ka realizuar kryesisht punime te ndertimit te cilat nuk jane objekti i prokurimit te autoritetit tone kontraktor.

Ne kontraten me nr.prot.----, date 16/12/2016 me objekt "Ndertim rruga Demokracia (ura Q. Babru ura F. Kercike)" me Bashkine Kamez, nga analiza qe iu be situacionit perundimtar nr.5 te paraqitur nga ofertuesi, Komisioni ka konstatuar si furnizime te ngjashme vetem zerin nr.analize: 2556 , me pershkrimin **F/v tuba b/arme fi 800 mbi shtrese betoni**, me vlere sipas situacionit **920 000 leke pa TVSH**. Kjo vlere perfshin dhe elemente te tjere si puntori per kryerjen e punes ne veper dhe material shtese ndertimore per realizimin e kontrates. Ky ze furnizimi ne kete kontrate nuk perfaqeson masen **40% te vleres se fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurron**.

c) Ne kontraten me nr.prot4308, date11 /12/2017 me objekt "Sistemim Rrugesh Blloku te Stadiumi" me Bashkine Pogradec, nga analiza qe iu be situacionit perundimtar nr.5 i paraqitur nga ofertuesi, komisioni nuk konstaton **furnizime me elemente beton-arme te ngjashme** qe mund te jene soleta te parapergatitura, arkitrare, kapake puseta b/arme, tombino apo te ngjashme me objektin e prokurimit te autoritetit kontraktor.

Meqenese Ofertuesi "SIRETA 2F"sh.p.k ka konkuruar per dy lotet duhet te plotesoje kushtin *ne masen 40% te vleres se fondit limit te shumatores së dy loteve për të cilat ka konkurruar, vlere e cila eshte 6 100 736 leke*.

Per sa u parashtrua me siper, operatori ekonomik "SIRETA 2F"sh.p.k nuk e ploteson kriterin e furnizimeve te ngjashme.

- Ka plotesuar te gjitha kriteret te tjera.

Kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates.

Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta, duhet te refuzohen si te papranueshme.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, "Per Prokurim Publik" (te ndryshuar) "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....", per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "SIRETA 2F" sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit per lotin 1: Blerje veshje nentokesore varri.

1. Operatori ekonomik "MENI"sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik "MENI" sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit.
- Ka plotesuar te gjitha kriteret e veçanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar.
- Ka keto mangesi ne kriteret e veçanta te kapacitetit teknik.

Kriteri 1: Ne DST ne shtojcen 9 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" te kapaciteti teknik ne piken 1, modifikuar me shtojcen 1 date 12.04.2019 eshte kerkuar per Loti 1:

*"Furnizime te ngjashme ne masen 40% te vleres se **fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurron**, te realizuar nga operatoret ekonomik gjate tre viteve te fundit nga data e tenderimit. Per kete duhet te paraqiten;*

- Kontrata furnizimi te ngjashme, vertetim te leshuar nga nje ent publik dhe fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

-Kur furnizimi i ngjashem është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do ta vertetojë furnizimin duke paraqitur faturën tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara."

Operatori ekonomik "MENI" sh.p.k ka paraqitur dy kontrata furnizimi perkatesisht;

- Kontraten date 29/06/2017 te lidhur me World Vision Albania me objekt sipas tabelës 1/aneksi 1 "Furnizim materiale ndertimi", amendim nr. 1, date 25.08.2017 shtese e kontrates se pare per disa mallra sipas tabelës nr.2.; Formular vleresimi; fatura tatimore nr.22-nr.25, date 31.08.2017; fatura tatimore nr.28- nr.31 date 21.09.2017.

- Kontraten e porosise date 17/07/2018 te lidhur me World Vision Albania me objekt sipas aneksi 1/ tabela nga 1-5; Realizim kontrate date 15.10.2018;formular vleresimi; fatura tatimore nr.77-nr.81 date 19.09.2018; fatura tatimore nr.83-nr.87 date 20.09.2018

Ne nenin 27 "Kontratat e Mallrave", pika 4 te VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, thuhet:

*"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon **dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme**, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Per permbushjen e ketij kriteri (furnizime te ngjashme) duhet te plotesohen tre komponente qe jane: koha e realizimit te furnizimeve, natyra e ngjashme e furnizimeve me objektin qe prokurohet

dhe vlera deri ne 40% te vleres se fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurron.

Nga kontratat e paraqitura nga ofertuesi “MENI”sh.p.k, plotesohet komponenti i pare i kohes se realizimit te furnizimeve, pasi te dy kontratat jane te realizuar brenda afatit tre vjecar nga data e tenderimit.

Ofertuesi “MENI”sh.p.k, nuk ploteson dy komponentet e tjere *te natyres se ngjashme te furnizimeve* qe permbajne kontratat me objektin e prokuruar nga autoritetit kontraktor dhe *te vleres se realizuar te furnizimeve te kerkuara* te analizuar si me poshte:

Komisioni konstatoi se materialet e specifikuara ne keto kontrata jane kryesisht materiale ndertimi inerte, elektrike, hidraulike dhe vetem ne kontraten date 17/07/2018 aneksi 1 tabela 4 ka furnizime te ngjashme tombino me fi 80cm, fi 40cm dhe fi 100cm me *vlere totale 240.143 leke pa TVSH*. Ndersa sipas fatures tatimore nr.86 date 20.09.2018 rezulton e realizuar ne *vleren 180 255 leke pa TVSH*, vlore e cila nuk permbush kushtin e 40% te vleres se fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurron operatori ekonomik.

Meqenese Ofertuesi “MENI”sh.p.k ka konkuruar per dy lotet duhet te plotesoje kushtin *ne masen 40% te vleres se fondit limit te shumatores së dy loteve për të cilat ka konkurruar, vlore e cila eshte 6 100 736 leke*.

Autoriteti yne kontraktor ne prokurimin e publikuar ka objekt te saj furnizime me elemente beton/arme e pasqyruar ne specifikimet teknike bashkelidhur dok. te tenderit, ku qartesisht jane publikuar skicat teknike te elementeve beton/arme te mallrave te kerkuara dhe jo furnizime me materiale inerte, hidraulike apo elektrike.

Inertet jane material ndertimi i fraksionuar ne permasa sipas kerkesave te investitorit si psh. Cakull, rrere zhavor etj, ndersa veshjet nentoksore te varrit dhe bordurat provizore te varrezave **jane elemente beton/arme te parapergatitur me nje teknologji te caktuar**. Si elemente kane forme, permasa dhe specifikime teknike te caktuara, te cilat jane paraqitur ne dokumentacionin teknik te prokurimit publik. Cdo llogaritje per percaktimin e fondit limit eshte bere ne baze te ketij klasifikimi.

Menyra e transportit midis inerteve dhe elementeve te parapergatitur beton-arme eshte krejtesisht e ndryshme. Kemi te bejme me element beton-arme te cilat per shkak te trashesise se tyre 4 cm dhe me gjatesi 1.80m (bordurat permasa max) dhe 1.05 (veshjet nentoksore), cka do te thote zbatim rigoroz i KT ne transport per te evituar plasaritje apo dhe thyerje te ketyre elementeve, gje e cila nuk mund te thuhet per materialet inerte.

Per sa u parashtua me siper, operatori ekonomik “MENI”sh.p.k nuk e ploteson kriterin e furnizimeve te ngjashme.

Kriteri 2: Ne DST ne shtojcen 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik pika 2 eshte kerkuar per Loti 1:

“Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 2 mjete kamion për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor. Mjetet te jene ne pronesi ose me qera shoqeruar me dokumentet:

A. Për mjetet ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) certifikat transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme). Te gjitha mjetet te shoqerohen me fotografi te tyre, ku te dallohet targa dhe marka.

B. Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit a) leje qarkullimi, b) çertifikaten e kontrollit teknik (i vlefshem), c) siguracionin e mjetit (i vlefshem) dhe d) certifikat

transport mallrash nga pushteti vendor (e vlefshme), si dhe duhet te shoqerohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit te këtij prokurimi. Te gjitha mjetet te shoqerohen me fotografi te tyre, ku te dallohet targa dhe marka.”

Op.ek “MENI”sh.p.k ka paraqitur dokumentet per dy mjete transporti, perkatesisht per mjetin ne pronesi me targa AA562AH dhe mjetin me qera me targa KO9323B.

Nga verifikimi i dokumentave rezulton se ka paraqitur keto dokumente per mjetin me qera me targa KO9323B:

- Kontrate qeraje nr.3635 Rep me nr.775Kol, date 13.11.2017.
 - Leje qarkullimi nr.KO 0011092.
 - Police sigurimi nr.532, date 21.06.2018 e vlefshme.
 - Çertifikate e kontrollit teknik e vlefshme.
 - Çertifikate e pronesise se mjetit, leshuar ne emer te“Xhengo” sh.p.k.
 - Çertifikate nr.126, date 07.02.2017 “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” te leshuar nga pushteti vendor ne emer te perdoruesit “Xhengo” sh.p.k..
- Ne nenin 3 pikat 3.13 dhe 3.18/ “b” te ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndyshuar percaktohet se: *“3.13 Transport për vete: **transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet.** Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.*
- “3.18 Certifikatë: b) dokument që i jep të drejtë një mjeti vetëm për transportin e mallrave për vete brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me pikën 3.13 të këtij ligji”*

Ne Udhëzimin Nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar eshte percaktuar modeli nr.210 i Çertifikates “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” i cili ne pjesen e dispozitave te pergjithshme percakton ne piken 2 se:

*“Transporti i mallrave per llogari te vet brenda vendit : transporti i mallrave me kamion brenda vendit, ne vajtje ose kthim, **vetem per llogari te veprimtarise se vete ndermarrjes se transportit.** Ne kete rast, transporti eshte vetem nje veprimtari ndihmese e veprimtarise kryesore te ndermarrjes se transportit, **mjeti eshte ne prone ose me kontrate qeramarrje** i asaj ndermarrje dhe drejtohet nga nje punonjes ose anetar i saj”.*

dhe ne piken 5 percaktohet se :*“Çertifikata nuk mund te transferohet nga mbajtesi i saj tek nje subjekt tjetër”.*

Operatori ekonomik “MENI” sh.p.k ka marre me kontrate qeraje me date 13.11.2017 mjetin me targa KO9323B nga qiradhenesi “XHENGO” sh.p.k, duke u bere perdorues i ketij mjeti nga data e marrjes me qera e ne vazhdim. Per rrjedhoj Çertifikata “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” e paraqitur ne dokumentat e ofertuesit, duhet te kishte si perdorues te mjetit personin juridik “MENI” sh.p.k, ndersa Çertifikata nr.126, date 07.02.2017 “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” eshte leshuar ne perdorim te subjektit juridik “XHENGO” sh.p.k.

Per sa u parashtua me siper, operatori ekonomik “MENI”sh.p.k nuk e ploteson kriterin qe disponon 2 mjete kamion për transportimin e mallrave sipas nevojave te autoritetit kontraktor, pasi per mjetin me qera Çertifikata “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet” nuk eshte ne emer te perdoruesit te mjetit “MENI” sh.p.k, sipas kontrates se qerase.

Kriteri 3: Ne DST ne shtojcen 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik ne piken 3 ka kerkuar per Loti 1:

*“Çertifikaten ISO 9001-2015 per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise te akredituar nga institucione shteterore vendase ose te huaja, **objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prourimit (e vlefshme).**”*

Objekti i prokurimit i procedurës së prokurimit për Loti 1 është “Blerje veshje nentokesore varri”, pra kemi të bëjmë me një kontratë të furnizimit të mallrave elementare të parapërgatitura hekur-beton, të cilat janë materiale ndërtimi.

Operatori ekonomik “MENI” sh.p.k ka paraqitur në sistem Çertifikatën EN-ISO 9001:2015 me numër 1710AL53Q për sistemin e menaxhimit të cilësive me përmbajtjen sa më poshtë:

“Ndërtime civile dhe industriale. Punime germimi në tokë. Rikonstrukcione, mirembajtje, veshje fasadash. Ndërtim rrugë, autostrada, mikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Ndërtim, ujësjellës, gazsjellës, vejsjellës, vepra kullimi, vaditje. Ndërtim për N/kabllorë e transformator, linja tensioni të lartë dhe të mesme dhe shpërndarjen e energjisë. Punime për prishjen e ndërtimeve, impiante ngritëse dhe transportuese (ashensor, shkallë levizëse), barrierë e mbrojtje rrugore, sinjalistike rrugore jo ndricuese, ndërtime parafabrikate, b/arme metalike dhe druri. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radio telefoni, TV etj. Punime topogjeodezike.”

Referuar përmbajtjes së çertifikatës ISO 9001-2015 të Operatorit ekonomik “MENI” sh.p.k nuk rezulton që të jetë çertifikuar për menaxhim të cilësive për tregtim të materialeve të ndërtimit, por punime ndërtimi.

Nëse do të bëjmë një krahasim me çertifikatat ISO 9001-2015 të paraqitura nga operatorët ekonomik të tjerë, pjesëmarrës në këtë procedurë, vërejmë se në përmbajtjen e tyre përfshihet ndër të tjera tregtimi i materialeve të ndërtimit.

Referuar sa më sipër, objekti i çertifikatës ISO 9001-2015 të operatorit ekonomik “MENI” sh.p.k nuk përputhet me objektin e prokurimit të autoritetit kontraktor.

Për sa u përket parashtesa më sipër, operatori ekonomik “MENI” sh.p.k nuk e plotëson kriterin e çertifikatës ISO 9001-2015 në përputhje me objektin e prokurimit.

- Ka plotësuar të gjitha kriteret të tjera.

Kriteret për kualifikim vendosen që të shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësive të operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në zbatim të nenit 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, “Për Prokurim Publik” (të ndryshuar) “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit....”, për sa më sipër oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “MENI” sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret dhe specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Funerale në dokumentet e tenderit për lotin 1: Blerje veshje nentokesore varri.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “SINDER AB” sh.p.k. Adresa: Rr. “Shefqet Ndroqi”, Sanatorium, Tiranë, Cel: 0682049311, e-mail: Sindera_b@yahoo.com se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9 890 000 (nente milion e tetëqind e nentëdhjetë mijë) leke pa TVSH.** / pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Agjencisë së Shërbimeve Funerale, me adrese Rr. "Durrësit" nr.132, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 7 (shtate) ditëve ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.05.2019.

Ankesa: Nuk ka patur ankesa

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____